



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.989/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “IPKO Telecommunications” LLC me seli në Prishtinë, Lagjja Ulpiana, Rr.”Zija Shemsiu” nr.34, kundër të paditurës Komuna e Vitisë, me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni fiskal, A.nr.220/19, të datës 03.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.07.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal A.nr.220/19 i datës 03.03.2021, dhe gjykohet si ne vijim:
 - 1) APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, ANULOHET aktvendimi me nr. protokoli 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019 i Komunës së Vitisë.
 - 2) Obligohet Komuna e Vitisë, qe paditësin Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, ta liroj nga borxhi i taksës - tatimit ne vlere prej 1700€ për periudhën 2018, e caktuar me vendimin nr. protokoli 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019.
- II. Pika III (tre) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal, A.nr.220/19 i datës 03.03.2021, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të gjykatës shkallës së parë, në pikën I. të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “IPKO Telecommunications” LLC me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Komunës së Vitisë me nr. protokoli 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019, si i paligjshëm, dhe që të detyrohet e paditura që paditësin ta liroj nga taksat komunale për vitin 2018 në shumë prej 1,700.00€ (një mijë e shtatëqind euro). Në pikën II të

dispozitivit të aktgjykimit është lënë në fuqi vendimi me nr.protokoll 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019 i Komunës së Vitisë. Ndërkaq në pikën III. të dispozitivit Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në konflikt administrativ.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të ligjit për Konfliktet Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, të ndryshoj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni fiskal, apo te njëjtin te anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar me nr.protokoll 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019, e paditura Komuna e Vitisë, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit të ushtruar kundër vendimit të Komunës së Vitisë - Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencës me nr.protokoll 09-035-02-1192 i datës 15.11.2018, me të cilin vendim paditësit i janë caktuar taksat komunale në shumë të përgjithshme prej 1,700.00€, në emër të vendosjes së stacioneve bazë BTS të operatorit, në lokacionet ku gjenden BTS (antenat), në territorin e Komunës së Vitisë, për vitin 2018.

Paditësi përmes të autorizuarit, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 24.01.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Komuna e Vitisë, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi me nr.02-320/04-57823 i datës 08.01.2019 si i kundërligjshëm dhe që të detyrohet e paditura Komuna e Vitisë që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e komfor dispozitave të nenit 65 të LKA-së. Më tej ka theksuar se vendimi i të paditurës me të cilin është refuzuar ankesa është i kundërligjshëm, pasi që ky vendim është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenit 47, 48 dhe 134 par.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi i kundërshtuar nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ siç parashihet me këto dispozita, respektivisht vendimit i mungon arsyetimi i plotës pasi që arsyetimi i dhënë në vendim është arsyetim i përgjithësuar dhe nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore të paditësit në padi në lidhje me zbatimin e dispozitave të Ligjit të Ndërtimit, Ligjit për Komunikime Elektronike dhe Postare, pastaj pretendimet e paditësit se taksa vjetore është barrë e rëndë për paditësin dhe se antenat janë të vendosura në prona private për të cilat paditësi paguan qira, ndërsa pronarët paguajnë tatimin në pronë.

E paditura Komuna e Vitisë, përmes të autorizuarit, në përgjigjen në padi të datës 21.07.2020 ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe jo ligjore, me arsyetimin se me asnjë provë nuk vërtetohet se vendimi me nr. dhe datë si në kërkesëpadi duhet të anulohet. Ka shtuar se për të paditurën vendimi me nr. 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019 është i bazuar dhe ligjor dhe ka arsyetim të plotë, sepse i njëjti është i bazuar në Rregulloren nr.01-110/05-997 i datës 28.01.2018, e cila rregullore është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë. Rregullorja e lartshënuar shumë qartë i definon taksat, ngarkesat dhe gjobat për çdo operator-kompani të cilat zhvillojnë veprimtarin e tyre qoftë edhe për paditësin në nenin 12.1.1 pika a dhe c dhe nenin 12.1.2. Rregullorja nr.01/110/05/997 e datës 28.09.2018 e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë e cila është certifikuar nga MAPL, dhe se Ligji për Qeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049 i'a mundësojnë komunave që në mënyrë të pavarur ti përcaktojnë taksat komunale.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave ka marr aktgjykimin e ankimuar me të cilin, në pikën I. të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit "IPKO Telecommunications" LLC me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Komunës së Vitisë me nr. protokollin 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019, si i paligjshëm, dhe që të detyrohet e paditura që paditësin ta liroj nga taksat komunale për vitin 2018 në shumë prej 1,700.00€ (një mijë e shtatëqind euro). Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është lënë në fuqi vendimi me nr.protokollin 02-320/04-57823 i datës 08.01.2019 i Komunës së Vitisë. Ndërkaq në pikën III. të dispozitivit Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në konflikt administrativ.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalles së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktin administrativ nenit 43 dhe 44 si dhe në shkelje të nenit 183 parag. 1 dhe 2 të LPK-se, si dhe aktgjykimin e atakuar ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore ka qëndrim tjetër juridik lidhur me interpretimin e normës juridike në raport me gjykatën e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadija e paditëses del të jetë e bazuar, me çka në rastin konkret ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ku edhe u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimit.

Lidhur me pretendimet ankimore se autoriteti kompetent për dhënien e lejeve për vendosjen / ndërtimin e antenave është ministria e Mjedisit dhe jo komunat, kolegji i ka pranuar si të arsyeshme pretendimet e tilla dhe këto pretendime i ka shqyrtuar në vështrim të nenit LIGJI Nr. 04/l –110 për Ndërtim neni 19 parasheh se "*Kompetencat për lëshimin e lejes ndërtimore 1. Ministria ka kompetencë për lëshimin e lejeve për ndërtimet e kategorisë III, sipas Shtojcës nr. 1 të këtij ligji. 2. Komunat lëshojnë leje ndërtimore për kategoritë I dhe II të ndërtimeve. Ndërsa sipas Shtojcës nr. 1 të këtij ligji 1.16. objektet e telekomunikacionit, përkatësisht rrjetit, sistemet ose pajisjet të cilat janë të rëndësishme ndërkombëtare dhe magjistralet si dhe ato të cilat ndërtohen në territorin e dy apo më shumë komunave*". Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues dhe

vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i ligjshëm pasi që gjykata e shkallës së parë gabimisht konstaton se në rastin konkret e paditura me vendimin me nr.09-035/02-1192 të datës 15.11.2018, nuk ka aplikuar taksë apo tatim në pronë për pronën e paluajtshme, por ka aplikuar tarifë vjetore për paditësin, për leje për vendosjen e transmetuese (anteneve) me frekuenca të ndryshme për nevoja të telefonisë mobile, fikse, televizionit dhe tjera të ngjashme.

Andaj kolegji vlerëson se janë te paqëndrueshme dhe te paqarta arsyetimet e vendimit kontestues kur deklaron se taksa ka të bëjë me taksë për leje për ushtrimin e veprimtarisë. Kjo për faktin se çështja e ushtrimit të veprimtarisë i nënshtrohet vetëm taksave përkatëse biznesore apo atyre të parapara me Ligjin nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike dhe e paditura nuk mund të merr inicative për ta obliguar paditësen për të paguar taksa të tjera përtej atyre të përcaktuara me ligjet përkatëse.

Kolegji i kësaj gjykate pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale të cilat janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, në raport me dispozitat ligjore të aplikueshme në rastin konkret pranon si të bazuara në ligj kërkesëpadinë e paditësit pasi që në bazë të nenit 22 paragraf 6 të Ligjit 04/L-109 për Komunikim Elektronike parasheh se: *“Ndërtimi i rrjetave publike të komunikimeve elektronike si dhe faciliteteve shoqëruese është në interesin publik. Taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe ato për rrjetat mobile (GSM), stacionet bazë, satelitët dhe infrastruktura nëntokësore.* Ndërsa në përkufizimet e ligjeve parashihet se me facilitetet nënkuptojmë shërbime të lidhura, infrastruktura fizike dhe objektet tjera ose elementet që lidhen me një rrjet dhe ose me një shërbim të komunikimeve elektronike të cilat mundësojnë dhe ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe ose shërbimi ose që kanë potencialin për ta bërë këtë dhe përfshijnë, ndër të tjera, edhe ndërtesat apo hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe konstruktionet tjera mbështetëse, kanalet, përçuesit, shtyllat, pusetat, dhe kabinetet. Andaj në interpretimin e drejtë të këtyre dispozitave ligjore kuptohet se taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimit publik, dhe këto rrjete janë të liruara nga pagesat e tatimit në pronë. Ndërkaq, e paditura nuk ka arsyetuar se mbi cilën bazë është marrë Rregullorja komunale mbi të cilën janë përcaktuar taksat komunale për vendosjen e stacioneve bazë BTS, respektivisht ku e mbështet e paditura të drejtën e saj për përcaktimin dhe ngarkimin e taksave të tilla.

Kolegji sqaron se në situatën e njëjte juridike Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykim në rastin nr. KI 189/20 Parashtrues IPKO Telecommunications L.L.C. Prishtine, me 11 nëntor 2021 Nr. ref. AGJ 1889/21 Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZPV. nr.17/2020, të 20 janarit 2020, e cilin aktvendim ishin gjete shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (e drejta për një proces të rregullt).

Kolegji vlerëson se në rrethanat e rastit konkret Ligji për Komunikime Elektronike është ligj special në krahasim me ligjet tjerë dhe se në asnjë rrethanë nuk janë paraparë të drejta epr pranimin e taksave nga organet komunale në raport me dispozitat e këtij ligji. Gjykata ka vlerësuar bazën

ligjore që ka të bëjë me statusin e objektit të kontestit edhe nga dispozita e nenit 22 paragrafi 6 të Ligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike, ku ka konstatuar se taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për objektin-antena satelitore pronë e paditësit. Andaj gjykata e obligonë të paditurën që paditësin Ipko Telecommunications LLC me seli ne Prishtinë të liroj nga borxhi i tatimit në taksës komunale për periudhën 2018.

Bazuar në të sipërcekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë mbi gjendjen faktike gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj është dashtë që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe te aprovohet kërkesëpadia e paditësit.

Nga të cekurat konform Nenit 195.1 pika e) e LPK-së u vendos si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.989/22, me datë 20.07.2023

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dren Rogova**